



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.193 dt.24.12.1998

MBI

**“NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT TE FONDEVE TE MIRATUARA NE
V.K.BASHKISE NR.129, DT.02.10.1998 PIKA.1, E”**

Këshilli i Bashkisë Tiranë, i mbledhur sot me dt.24.12.1998, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme që shuma prej 700.000 lekë e parashikuar për ndërtim të soletës drejtuese për zyrat e reja t’i ndysohet destinacioni në fond për shtrimin e pllakave të korridorit të Bashkisë dhe ndërtim të kabinës së rojes tek porta e Bashkisë pasi Këshilli i Bashkisë Tiranë, me vendimin e tij Nr.129, dt.02.10.1998, pika.1 e, ka miratuar shumën prej 914.953 lekë për ndërtimin e murit ndarës dhe soletës drejtuese për zyrat e reja në oborrin e Bashkisë. Realizimi i soletës drejtuese për zyrat e reja të përkohëshme të Bashkisë, parashikuar në shifrën 700.000 lekë u kursye në tenderin e realizuar me Urdhër Prokurimi Nr.486, dt.25.09.1998 “Mbi prokurimin për ndërtimin e ambjenteve të reja për zyra”, gjithashtu nga fondi prej 2.500.000 lekë miratuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr.129, dt.02.10.1998 “Mbi miratim fondesh”, vetëm fondi prej 1.800.000 lekë është prokuruar me Urdhër Prokurimi Nr.525, dt.30.10.1998 “Mbi prokurimin për punime hidrosanitare, hidroizolim tarace, lysterje e ambjenteve të brendëshme për njësitë administrative Nr.7, 8, 9, suvatim i jashtëm i godinave në njësitë administrative Nr.1, 2, 5 dhe ndërtim të murit ndarës në oborrin e Bashkisë”. Mbështetur në Ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e destinacionit të fondeve për ndërtim të soletës drejtuese për zyrat e reja, në fond për shtrimin e pllakave të korridorit të Bashkisë dhe ndërtim të kabinës së rojës tek porta e jashtme e Bashkisë.
2. Fondi për shtrimin e pllakave të korridorit të Bashkisë dhe ndërtimin e kabinës së rojes tek porta e jashtme e Bashkisë është 700.000 lekë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI